

Thirrja: “PROJEKTE TË KËRKIMIT SHKENCOR”

Projekte në mbështetje të kërkimit shkencor dhe në mbështetje të kërkuesve të rinj

“Sfidat e përkthimit terminologjik në dinamikat e reja kombëtare dhe globale të Shqipërisë. Përkthimi i terminologjisë së trashëgimisë kulturore dhe juridiko-administrative”

Anastasi Prodani

Departamenti i Gjuhes spanjolle

FGJH, UT

PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Konteksti: Në kuadër të strategjisë kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në Shqipëri + me dinamikat e reja rajonale e globale me hapjen e negociatave të Shqipërisë dhe Be-së + dhe nënshkrimin me Qeverinë e Mbretërisë së Spanjës te marrëveshjes dypalëshe të ekstradimit.

- *E kemi konceptuar në dy fusha kryesore veprimi:*
 1. *përkthimi terminologjik*
 2. *komunikimi turistik*

JUSTIFIKIMI

- *Ky projekt do të fokusohet në këto dy drejtime: në përkthimin e terminologjisë së trashëgimisë kulturore por edhe të asaj juridiko administrative / gjyqësorit.*
- *Ky imperativ del në një situatë kur kurrikulat tona më shumë se kurrë duhet t'i qasen tregut të punës dhe politikave kombëtare e europiane të zhvillimit të vendit.*

PYETJET: A është e përgatitur Shqipëria për të përballuar me sukses këto dinamika të reja në fushën e përkthimit terminologjik të turizmit dhe të asaj juridiko-administrative? A janë të përgatitur muzeumet dhe sitet arkeologjike për të përballuar një fluks kaq të madh turistësh spanjishtfolës?

PERVOJAT E MEPARSHME

- *Një përpjekje e parë në këtë fushë është bërë po nga Departamenti i Gjuhës spanjolle 5 vite më parë në bashkëpunim edhe me Ambasadën e Mbretërisë së Spanjës në Tiranë dhe me Muzeun Historik Kombëtar, ku si produkt u botuan dy katalogë dhe dy fletëpalosje të këtij muzeu. Ky projekt u pasua nga bashkëpunimi edhe me Muzeun Ikonografik dhe Etnografik, Berat, ku përsëri dolëm me disa produkte.*

OBJEKTIVAT E PERGJITHSHEM

- *Të ofrojmë përkthimet tona dhe ekspertizën tonë në përputhje me tregun e punës dhe të dinamikave të reja kombëtare e globale.*
- *Të diversifikojmë aftësitë në përkthimin terminologjik në fushën e trashëgimisë kulturore dhe asaj juridiko-administrative.*
- *Të ofrojnë përkthimin e informacionit turistik të muzeumeve dhe siteve arkeologjike edhe në gjuhën spanjolle.*

OBJEKTIVAT afatshkurtër

- *Të ofrojnë përkthimin e informacionit turistik konkretisht të muzeve të lartpërmendur të Krujës, dhe të Muzeut të Përgjimeve „Shtëpia me Gjethe“ dhe të Arkeologjikut të Tiranës edhe në gjuhën spanjolle.*
- *Të zhvillojmë më tej aftësitë e punës në grup, debatin konstruktiv dhe punën në terren.*
- *Ta ndajmë këtë përvojë me studentet dhe mes kolegësh të fushës dhe ta ngremë përvojën tonë edhe në rrafshin akademik.*

OBJEKTIVAT afatgjatë

- *Kjo fazë e parë do të na ndihmojë që të hedhim themelet e punës për një fazë të dytë, ku do të punohet për hartimin e dy glosarëve dygjuhësh: njëri me terma të lëmit juridiko-administrativ dhe tjetri me terma të trashëgimisë kulturore, në mënyrë që këto produkte t'i shërbejnë si instrumente pune përkthyesit dhe udhërrëfyesit të spanjishtes në punën e tij të përditshme.*

KOHEZGJATJA

- *Projekti është konceptuar të bëhet në dy faza, dhe konkretisht në këtë projekt propozim që po paraqesim do të ndalemi vetëm tek një numër i kufizuar muzeumesh, vetëm 4 (katër) me të cilët kemi vendosur kontakte dhe kemi planifikuar disa hapa konkretë për ta realizuar me sukses si një projekt njëvjeçar.*
- *Nga suksesi ose jo i vitit të parë do punojmë për hartimin e fazës së dytë, ku dhe do të konkretizojmë objektivat afatgjata.*

Grupet e synuara/përfituesit

- *1. Muzeumet*
- *Muzeu i Skënderbeut dhe Muzeu Etnografik, Krujë (si muze pilotë)*
- *Muzeu i Përgjimeve „Shtëpia me Gjethe“*
- *Muzeu Arkeologjik, Tiranë*
- **2. Studentët**
- **3. Stafi akademik**
- **4. Turistët spanjishtfolës**

METODOLOGJIA

- *Krahas përkthimeve dhe punës në terren me specialistë të fushës, ku pretendojmë të dalim edhe me botime fletëpalosjesh/ broshurash, posterash apo audioguida, do të organizohen dhe 2 aktivitete shkencore: seminar mbi përkthimin sipas qasjes konjitivo-funksionale dhe konferencë shkencore në fund të vitit mbi tematikat në fjalë.*

PLANI I PUNES

- *Në gjashtëmujorin e parë:*
- *Faza e diagnostifikimit dhe e ndërveprimit me institucionet /muzetë e sitet e tjera arkeologjike si dhe firmosja e kontratës me dy muzeume pilote, që tashmë i kemi kontaktuar. Gjatë kësaj faze bëhet identifikimi i mungesave dhe i nevojave në spanjisht të materialeve që disponojnë muzeumet dhe sitet e tjera arkeologjike të një rëndësie kombëtare, për t'i hapur rrugën një bashkëpunimi me to në një fazë tjetër.*

PLANI PUNES

- *Në gjashtëmujorin e dytë:*
- *Planet e Përmirësimit, ku do të konkretizohet puna për sigurimin e bashkëpunimit me muzeume e site arkeologjike duke firmosur kontratat tashmë edhe me këto institucione. Paralelisht do të bëhet dhe vlerësimi i përkthimeve ekzistuese në spanjisht (nëse ka ndonjë të tillë) dhe më pas rishikimin dhe përkthimin e tyre dhe të materialeve të muzeumeve pilote.*

HAPAT KONKRETE

- *Identifikimi i situatës nëpër muzetë e tjerë dhe sitet arkeologjike, që janë të një rëndësie kombëtare në fushën e turizmit.*
- *Marrja në dorëzim e materialeve nga personi përgjegjës i muzeumeve që tashmë kemi kontaktuar si: Muzeu i Përgjimeve „Shtëpia me Gjethe“, Muzeu i Skënderbeut dhe Etnografik, Krujë si dhe nga Muzeu Arkeologjik, Tiranë.*
- *Nënshkrimi i kontratave me 4 muzeumet.*
- *Njohja e pedagogëve me këto materiale dhe ndarja e punës.*
- *Rishikimi i materialeve ekszistuese si edhe përkthimi i informacionit të ri.*
- *Diskutime periodike në grup mbi terminologjinë juridiko-administrative dhe nënfushave më të ngushta të saj*

HAPAT KONKRETE (vazhdimi)

- *Seminar formimi dhe tavolinë e rrumbullakët mbi problemet e ndryshme gjatë përkthimit të terminologjisë që lidhet me trashëgiminë kulturore dhe atë juridiko-administrative.*
- *Dorëzimi, korrektimi dhe redaktimi i materialeve.*
- *Monitorimi dhe kontrolli teknik i përkthimeve nga specialistë.*
- *Kontrolli i punimeve shkencore nga Komiteti shkencor i ngritur për këtë qëllim.*
- *Zhvillim të aktiviteteve ekstrakurrikulare me studentët e masterit*
- *Printimi i materialeve/ broshurave/ posterave të plastifikuar format A4/ fletëpalosjeve apo audioguidave sipas formateve, që kërkojnë muzeumet.*
- *Botimi i tyre*
- *Promovimi i botimeve pranë institucioneve*
- *Shkëmbimi i eksperiencës dhe me departamentet e tjera të FGJH-së dhe më tej.*

ANALIZA E RISKUT

Ndër risqet që parashikohen janë:

- 1. Rreziqe që lidhen me institucionet e tjera që do të bashkëpunojmë*
- 2. Rreziqe që lidhen me burimet njerëzore*

FALEMINDERIT